REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 965/20
Datë/Datum. 18.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **203-20-3525-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet të kontrollit dhe zhvillimit të kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Geo&Land sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bardhyl Qaushi C15/11, 10000 Prishtine
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044224853 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ymer Kuka
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@geoland-kosova.com
(Adresa elektronike)

18/11/2020 — _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

Geo&Land sh.p.k
Muharrem Fejza
10000, Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- ✓ ***Njoftimi për kontratë me date 17/07/2020***
- ✓ ***Njoftimi për tenderues te eliminuar dhe anulim të aktivitetit te prokurimit me date 28/10/2020***
- ✓ ***Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Bazuar në nenin 108A të LPP, me datë 30/10/2020 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK. Me datë 09/11/2020 kemi pranuar vendimin për refuzim nga AK. Si dëshmi, në bashkëngjitje të kësaj ankese po paraqesim kopjen e kërkesës dhe kopjen e vendimit të AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- ✓ *Ligji Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), Neni, 7, Neni 10, Neni 59, Neni 69, Neni 72 dhe Nenin 108/A.*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shtjellimi i çështjes

1) Me daten 28.10.2020 jemi njoftuar nga AK per eleminimin nga procesi tenderues. Bazuar në arsyetimin nga ana e AK, të paraqitur në njoftimin për eliminimin e ofertës tonë, ne kemi paraqitur dëshmitë tona dhe pretendimet për shkeljet ligjore në kërkesën për rishqyrtim të datës 30/10/2020, mirëpo përsëri AK me vendimin per refuzim te dates 9.11.2020 duke vepruar njëanshëm nuk ka marrë parasysh ato. **Rrjedhimisht ka shkelur nenin 108/A, paragrafin 10.2.**

2) Përveç fakteve të paraqitura në Kerkesen per rishqyrtim, ne si OE ofertues, jemi bazuar në kërkesën e specifikuar nga AK dhe kemi dërguar dëshmitë në bazë të kërkesës nr. 7 ku specifikohet:

   Kërkesa 7 OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme nga fusha e bujqësisë ose zhvillimit rural ose interpretimit te imazheve

satelitore për qëllime te monitorimit dhe kontrollit të kulturave bujqësore, në vlerë jo më pak se 1,935,000 € të gjitha.

Kërkesa në fjalë nuk specifikon periudhën kohore për referencat, përkundrazi specifikon "të gjitha". Pavarësisht kësaj, dhe në cilindo rast, oferta jonë e mbështetur në grup të OE, si dhe në kapacitetet e subjekteve tjera (AIRBUS DS) sipas nenit 69.8 të LPP-së, plotëson dhe tejkalon shumë herë kërkesën minimale numër 7.

Argumenti si me sipër për kërkesën nr. 7, është dëshmuar edhe nga Ekspertit Shqyrtues i OSHP ne vendimin nr. 571/20 te dates 07.09.2020 i cli sqaron si ne vijim:

Duhet të theksojmë se sipas nenit 68 par.1 të LPP-së, kufizohet maksimumi i asaj që lejohet të kërkohet nga AK për qarkullim në fushë specifike të përshirë në kontratë, AK lidhur me këtë pikë ka kërkuar maksimumin e lejuar me ligj, që është 1.5 herë të vlerës së parashikuar të kontratës.
Vlerësojmë se një vlerë më e ulët për qarkullim në fushë specifike dotë mundësonte një pjesëmarrje më të gjerë të OE-ve, me gjithë këtë kjo është kërkesë e cila mbetet në diskrecion të AK-së.

Ndoshta vlenë të theksohet se, te kërkesa për kapaciteti ekonomik financiarë për tri vite është kërkuar (bazuar në dosje të tenderer dhe përgjigjes për sqarime shtesë) qarkullim në vlerë 750.000€ për tri vite, ndërsa tek kapaciteti teknik/profesional është kërkuar 1,935.000€ për tri projekte të ngjashme, pa u përcaktuar periudha kohore e realizimit të atyre projketeve siq parashihet me nenin 69 të LPP-së.

Ndërsa sa i përket pjesës së dytë te kërkesës 7 ku thuhet : *interpretimit te imazheve satelitore për qëllime te monitorimit dhe kontrollit te kulturave bujqësore, në vlerë jo më pak 1.935.000€ te gjitha"*, mendojmë se kjo do të

Andaj kërkesa nr. 7 qe nuk specifikon periudhën kohore prej 3 vitesh është evidentuar edhe nga eksperti shqyrtues i lëndës. Pasi që kjo është evidentuar nga ESH, AK nuk ka marre asnjë veprim me tutje për qartësim apo ndryshim të saj. Andaj tenderi ynë është dorëzuar duke e plotësuar këtë kërkesë dhe të gjitha kërkesat tjera mbi kapacitetin teknik dhe/ose profesional. Ne këtë rast AK është i obliguar që vlerësimin e tenderëve ta bëjë në përputhje me kërkesën e paraqitur (nr.7) dhe jo ta ndryshojë atë gjatë procesi të vlerësimit ashtu siç ka vepruar, **duke shkelur nenin 59, paragrafi 4 i LPP-se.**

3) Dëshmia e kërkuar për kërkesën nr. 7 është si në vijim:
Dëshmia 7 OE duhet të ofroj listën e projekteve për tri vitet fundit para publikimit te njoftimit, ku duhet të ceket Autortiteti Kontraktues, vlera e projektit, data e realizimit të projektit bashkangjitur duhet të ketë referencat për shërbimet punët e realizuara.

Bazuar në këtë kërkesë ne kemi dorëzuar listën e projekteve për tre vitet e fundit (por edhe ketu nuk eshte cekur vlera minimale nga ana e AK), përfshirë të gjitha projektet relevante sipas kërkesë nr.7, të cilat tejkalojnë vlerën e kërkuar 1,935,000 €. Me këtë rast ne kemi përmbushur plotësisht kërkesën nr.7 dhe dëshminë e kërkuar dokumentare në lidhje me këtë kërkesë. Ne gjithashtu kemi dërguar ne email zyrtar ankesën dhe referencat në vlerë rreth 20 fish më tepër se ato të kërkuara sipas DT. AK bazuar ne nenin 72 nuk ka ndermarre asnje hap per te sqaruar faktet e ofruara, por thjesht nuk i ka trajtuar ato.

Është me se evidente qe AK ka vepruar ne kundershtim me LPP, gjegj. Nenin 72 dhe nenin 7.

Për të dëshmuar faktet, ne si OE ekonomik kemi ofruar deshmi qe tejkalojme kerkesat minimale edhe ne tri vitet e fundit dhe ate shumefish me shume, te cilat fakte do tia bashkengjisim kesaj ankese.

4) Ne baze te nenit 69 par. 8, Kompania jonë Geo&Land shpk me seli ne Prishtinë si përfaqësuese e autorizuar e kompanisë AIRBUS DS e regjistruar ne Toulouse, Francë, ka ofertuar pranë AK (MBPZHR). Sipas kërkesave te DT, OE duhet të ofrojë dëshmi për posedim të imazheve satelitore apo autorizim për ofrimin e këtij produkti dhe shërbimeve tjera përkatëse qe dalin nga DT. Lidhja juridike në mes të kompanisë Geo&Land shpk dhe AIRBUS DS i është dëshmuar prane AK përmes dy kontratave:

   a) Kontrate në mes të AIRBUS DS dhe Geo&Land Shpk për perfaqesim territorial per shitjen e produkteve dhe shërbimeve për territorin e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë (https://www.intelligence-airbusds.com/commercial-network/#map_mode)
   b) Kontratë/Deklarate bashkëpunimi për këtë projekt me nr të prokurimit adekuat.

Këto dy dokumente janë të bazuara në nenin 69 par. 8 të LPP, e cila sqaron marrëdhënjet specifike të OE ofertues.

Neni 69, par. 8 i LPP thekson, citojmë:

*[8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, **të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta.** Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. **Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera..]***

Pra duke u bazuar në këtë nen dhe paragraf, ne në ofertën tonë kemi dëshmuar pranë AK lidhjen ligjore me Kompaninë AIRBUS DS e cila ne fakt eshte ofrues is herbimeve dhe produkteve, e cila ka dëshmuar në propozimin teknik që është kompania më e madhe në botë për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve sic janë kërkuar nga AK (I tejkalon shumefish kerkesat e AK). Pra në ofertë janë paraqitur lista e projekteve të realizuara në fushën e njëjtë por e cila për habi nuk është marrë parasysh nga AK. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 69, pika 4 dhe pika 8, AK ka pasur të gjithë dëshmitë e nevojshme se oferta jonë plotëson të gjitha kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe/ose profesional. Duke marre parasysh këtë, për ne është e habitshme veprimi i AK, i cili gjithashtu në bazë të nenit 72 ka pasur mundësi të

kërkojë sqarime shtesë e jo të veprojë në formë arbitrare duke e shkelur këtë nen.

5) Me datë 10/11/2020 kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentet publike në lidhje me këtë procedurë të prokurimit. Kërkesa është bërë tek personi kontaktues sipas njoftimit për kontratë z. Bexhet Asllanaj (bexhet.asllanaj@rks-gov.net). Meqenëse nuk pranuam përgjigje, kërkesën e njëjtë e kemi përsëritur edhe me datë 11/11/2020. Dhe përsëri deri në datën që po dorëzojmë këtë ankesë ne nuk kemi pranuar përgjigje për qasje në dokumente (8 dite pas kerkeses). Me këtë rast, ne na është mohuar e drejta themelore për qasje në dokumente, rrjedhimisht **AK ka bërë shkelje të LPP-së, neni 10 dhe neni 7.** Ky refuzim nga ana e AK na jep dyshimin të mëdha për mbarëvajtjen e procesit si të parregullt dhe jo konform LPP.

Vendimi për vlerësimin e tenderit dhe vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë vendime krejtësisht ne kundërshtim me LPP, nenin 59 dhe nenin 69. Andaj, bazuar në faktet e paraqitura si më sipër, kërkojmë nga ju që të merrni vendim:

- **Të pranohet ankesa jonë si e bazuar.**
- **Të anuloni vendimin paraprak të AK të datës 28/10/2020.**
- **Të kthehet kjo procedurë tenderuese në ri-vlerësim.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlerësimi fillestar për të cilën kompania jonë dëmtohet në këtë rast është 20% e vlerës së ofertuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) Kërkesën për rishqyrtim e datës 30/10/2020 sipas nenit 108A te LPP
h) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
i) Kopjet e referencave

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*